

05, Nëntor 2015.

Zgjedhjet e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë

I dashur Dr Brahimaj,

Shoqata Mjekësore Botërore (WMA) ka pasur kënaqësinë për të punuar ngushtë me organizatën tuaj për shumë vite, si anëtare e WMA. Dihet se tipari bazë i sistemit shëndetësor që bashkon disa nga organizatat tona dhe shumicën dërmuese të vendeve të tjera në Europën Qendrore dhe Lindore është pëkushtimi jonë për një sistemi të vetëqeverisjes së mjekëve.

Përmes bashkëpunimit tonë me Urdhërin e Mjekëve të Shqipërisë, ne kemi mësuar në lidhje me rolin e rëndësishëm që organizata juaj luan në profesionin mjekësor të Shqipërisë dhe të besojmë në angazhimin e saj për respektimin e ligjeve dhe rregullave tuaja.

Për këtë arsye, ne ishim të befasuar kur dëgjuam për përfshirjen e Ministrisë së Shëndetësisë në procesin zgjedhor dhe në procesin gjyqësor të lartpërmendur. Në mënyrë që UMSH-ja të mbetet e efektshme në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare, ajo duhet të ruajë pavarësinë e saj nga çdo ndikim politik. Kjo është gjithashtu themelore për statusin e UMSH-së si një anëtare i rrregullt i organizatave ndërkombëtare, si Shoqata Botërore Mjekësore. Vetë-qeverisja rrit kompetencën profesionale, integritetin dhe promovon shkëmbimin kolegjal të përvojës dhe ekspertizës. Vetë-rregullimi i efektshëm i profesionit mjekësor është mënyra më e mirë për të siguruar cilësinë e kujdesit dhe të promovojë mirëqenien e tërë popullatës.

Në emër të Shoqatës Botërore Mjekësore, unë ju siguroj juve për mbështetjen dhe angazhimin tonë të vazhdueshëm ndaj kolegëve Shqiptar të profesionit mjekësor. Ne mbështesim plotësisht pavarësinë e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe i kemi bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë të Shqipërisë për të respektuar sistemin e vetëqeverisjes së mjekeve në vendin tuaj.

Ne ju urojmë forcë dhe vendosmëri për të përballur sfidat e tanishme me të cilat po ndeshet organizata juaj dhe ju bëjmë thirrje për të vazhduar avokimin për çka është më e mira në interes të mjekëve dhe pacientëve të tyre.

Sinqerisht,

Prof. Dr .Sir Michael Marmot

President

Dr.Ardis D. Hoven

Anëtar i Këshillit